


**ME VEPRIME TË VOGLA,**



**E NDËRTOJMË DEMOKRACINË**

## FUQIA E QYTETARËVE

ARTAN (14), ENGJËLL (14), PËLLUMB (14), ANITA (14), ELBASAN (14), SUNITA (15), ARGJEND (14)



**Ajo çka ne kemi ditur për demokracinë, nuk ka qenë e pakët. Por, ajo çka kemi mësuar sot, i ka pasuruar njohuritë tona që i kemi pasur. Në artikullin më poshtë, mund t'i lexoni informatat e reja që i kemi mësuar**

Nëse gjithçka ndodh për një arsye, atëherë arsyeja pse ne jemi këtu paraqet synimin tonë për të mësuar dhe për të kuptuar se cili është roli i qytetarëve në një shtet demokratik. Sot, është e lehtë të flasësh për rolin e qytetarëve, sepse koha në të cilën jemi duke jetuar, na jep mundësinë për të qenë pjesë e vendimmarrjes. Me këtë kuptojmë të drejtën e secilit prej nesh për të zgjedhur pa komplekse dhe pa imponime. Në fakt edhe ardhja jonë në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“,

është bërë pa asnjë lloj imponimi, pra me vetëdëshirë. Përfitimin që e kemi pasur sot, ka të bëjë me bashkimin e njohurive dhe ideve tona për të mirën e komunitetit. Kështu që sot patëm rastin të fuqizojmë edhe më shumë rolin e qytetarëve, duke kuptuar se vullnetarizmi është përbërës i pandashëm i qytetarisë aktive. Po ashtu, mësuam se edhe zbatimi i elementeve të demokracisë mund të hyjë në qytetarinë aktive. Vetëm duke treguar respekt, tolerancë, mirëkuptim dhe solidaritet mund ta vëmë në pah natyrën tonë sociale dhe rolin aktiv që mund dhe duhet ta kemi në shoqëri. Aktivizimi qytetar është përgjegjësi morale e secilit shtetas të Republikës së Kosovës. Të bashkuar, mund t'i ndihmojmë komunitetit tonë.



Ne jemi të lirë, sepse jetojmë në një shtet demokratik



Autorët e punimeve të artikullit

# VULLNETI I MIRË I QYTETARËVE BËN MREKULLI

ALI (15), FATBARDHA (14), BLEONA (14), ALBAN (14), BLENDUAR (15), VELI (14), SHPAT (14),


SUMEA (14), IBRAHIM (15)

**Në vijim do të mund t'i gjeni disa informata shtesë për qytetarinë aktive. Po ashtu, do të mësoni se pse qytetaria aktive është kaq e rëndësishme për të gjithë ne**

Qytetaria aktive ka lidhshmëri të madhe me përgjegjësinë morale që qytetarët e kanë për ta ndihmuar vendin ku ata jetojnë. Synimet e qytetarisë aktive kanë të bëjnë me sigurimin e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim. Duke investuar në aspektin e sigurimit të mirëqenies sociale, ne mendojmë se arrihet barazia dhe lumturia e qytetarëve.

Siç edhe e dijmë, që nga dajla në pah e sistemit demokratik, ka pasur zhvillim të vazhdueshëm në mënyrën e jetesës së qytetarëve. Krejt kësaj i ka paraprirë aktivizimi qytetar dhe dëshira e madhe për të ecur në hap


me kohën. Iniciativat e para për të ndryshuar diçka sigurisht që fillojnë nga të menduarit tonë. Duke e ditur se mendimet nëse nuk vihen në zbatim mbeten diçka abstrakte, ne dhe të gjithë qytetarët e tjerë të cilët jemi aktiv, aktivizohemi dhe i bëjmë mendimet konkrete. Kjo i bie se mendimet i kthejmë në vepra, në mënyrë që ato të tregohen efektive dhe mjaft të dobishme për të gjithë. Prandaj, me kënaqësinë më të madhe themi se vullneti i mirë i qytetarëve bën mrekulli. Ju ftojme që ta ndjeni këtë vullnet dhe t'i ftoni të tjerët t'iu ndihmojnë t'i realizoni idetë tuaja.



E drejta e shkollimit ka përgjegjësinë e të mësuarit



Autorët e shkrimit të këtij artikulli



Demos-ti, projekt që mëson qytetarët se si të bëhen aktiv



Shpërndarja e informatave bën pjesë në qytetarinë aktive



## KUVENDI NË JETËN TONË

BAJRAM (15), MILOT (14), EGZON (14), ELMA (15), MEDINA (15), EROLINA (14), FLORENTË (14),  
ELIZA (14)



Unë  
jam deputete që punoj në  
Kuvendin e Kosovës si përfaqësuese  
e qytetarëve, të cilët më kanë zgjedhur  
me votat e tyre. Unë jam zëri i tyre  
në Kuvend

Të  
gjitha problemet që  
qytetarët e mi i kanë, ne si  
deputetë mundohemi t'i zgjidhim  
duke miratuar kështu ligje

### Ky artikull flet për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Saranda është një vajzë, e cila ka arritur moshën 16 vjeçare. Ajo është shumë e lumtur, sepse tani që ka mbushur këtë moshë, ka një dokument identifikues. Ky dokument tregon se Saranda është shtetase e Kosovës dhe dokumenti në fjalë quhet letërnjoftim. Përkundër dëshirës së Sarandës për të pasur letërnjoftim që nga mosha 10 vjeçare, ajo ka qenë e vetëdijshme se



ligjeve është vetëm njëri nga funksionet e Kuvendit, që njihet si funksioni legjislativ. Funksion tjetër i Kuvendit është funksioni përfaqësues, sepse qytetarët i zgjedhin deputetët si përfaqësues të popullit. Si dhe funksioni i tretë është funksioni kontrollues, sepse institucioni më demokratik, Kuvendi, e kontrollon punën e Qeverisë, e cila i vë në funksion ligjet e marra nga Kuvendi. Ju mos harroni lexues, se gjithçka që ndodh në Kuvend ndikon në jetën e të gjithë neve. Ligjet që miratohen aty janë shtylla e demokracisë dhe rruga e jetës sonë.



duhet të pres deri sa të arrijë moshën 16 vjeçare. Kjo për shkak se kështu thuhet në ligjin për letërnjoftim. Në këtë ligj thuhet se: „Letërnjoftimi nënkupton dokumentin publik që përmban të dhënat personale në formë fizike dhe elektronike, i cili i lëshohet shtetasit të Republikës së Kosovës për të vërtetuar identitetin dhe shtetësinë e bartësit të dokumentit.“


A e dini nga ka ardhur ky ligj? Ky dhe të gjitha ligjet e tjera, miratohen në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi është institucioni më demokratik në vendin tonë. Miratimi i



Gazetarët e artikullit

# PROCESI MË DEMOKRATIK

ARBEN (15), LEONORA (15), EDISON (15), ERZA (14), FATJONA (14), TEUTA (14), AGENSA (14),  
FITIM (14), DENIS (14)



## A e dini ju se cili është procesi më demokratik në Kosovë? Këtë do të arrini ta mësoni nga artikulli dhe shembulli në vazhdim

Unë jam Leonora, jam nxënëse e klasës së IX-të në shkollën fillore „Bedri Gjinaj“ në Mitrovicë. Njëherazi jam anëtare e Asamblesë së Fëmijëve në Mitrovicë. Asambleja e vendit tonë është organ legjitim, i cili merret me organizimin e aktiviteteve, të cilat kanë qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Më lart, për-



Një votë e juaj një shpresë për të ardhmen

menda që Asambleja vepron si organ legjitim, prandaj ajo përbëhet edhe nga kryesia. Sa i përket zgjedhjeve për kryesinë e Asamblesë, ato bëhen në mënyrë të mbyllur ose në mënyrë të hapur. Krahas këtij veprimi, ne arrijmë që t'i zgjedhim përfaqësuesit, të cilët do ta udhëheqin Asamblenë për një periudhë 2 vjeçare. E gjithë kjo i bie që ne arrijmë të organizojmë zgjedhje demokratike, të gërshtuara me lirinë e gjithseci-

lit për të zgjedhur. Edhe shteti ynë Kosova, organizon zgjedhjet të cilat mund të kenë karakter qendror ose lokal. Në të dy rastet, qytetarët kanë lirinë të zgjedhin udhëheqësit, të cilët do t'i përfaqësojnë ata në institucionet përkatëse. Populli në zgjedhjet qendrore zgjedh deputetët, të cilët do të na përfaqësojnë në Kuvend. Ndërsa, në zgjedhjet komunale ne kemi mundësinë të zgjedhim Kryetarin ose udhëheqësin tonë të Komunës për 4 vjet, bashkë me të drejtën për të zgjedhur dhe asamblistët. Krahas të drejtës së votës, ne kemi edhe përgjegjësi. Prandaj, përgjegjësia jonë është që të mendojmë mirë paraprakisht dhe të analizojmë planet qeverisëse të ofruara nga kandidatët. Vetëm në këtë mënyrë, ne arrijmë të zgjedhim individët e duhur për të na përfaqësuar për 4 vjet. Këto vite janë shumë me vlerë për ne. Andaj, ne apelojmë që në zgjedhje të votohet në numër sa më të madh dhe të mbajmë përgjegjësi për këtë proces kaq të rëndësishëm.



Analizuesit e procesit zgjedhor të Kosovës





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Bedri Gjinaj“  
Klasa: IX-1  
Vendi: Mitrovicë